



Asambleja
01.Nr.VI
Deçan,dt.31.05.2021

PROCESVERBAL

I mbajtur për mbledhjen e rregullt, mbledhja e VI-të me radhë e Asamblesë Komunale , e mbajtur me dt.31.05.2021.

Në mbledhje ishin prezent:23 anëtarë të asamblesë, Kryetari i Komunës, disa drejtor të drejtorive komunale, OJQ, Zyrtarja për Informim.

Mbledhjen e kryesoj dhe e udhëhoqi kryesuesi i Kuvendit, zotëri Haki Shehaj.

Për mbledhje ishte propozuar ky rend pune:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Shqyrtimi i Qarkores së parë buxhetore;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës së Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sporte për bashkëfinancim me CHWB Kosova, në projektin “Muzealizimi i Kullës-Muze të Dëshmorëve” në Gllogjan-shuma 24,500 €;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës së Drejtorisë për BPZHR për ndarjen e mjeteve financiare për hapjen dhe mirëmbajtjen e kanaleve të ujitjes në bashkë-financim me K.R.U.”Drini i Bardhë”;
5. Shqyrtimi i propozimit të Kryetarit për miratimin e Vendimit paraprak për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës- parcela nr.1294-1 Zk Deçan dhe formimi i komisionit vlerësues;
6. Formimi i dy(2) komisioneve Vlerësuese për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës;
7. Formimi i Komisionit të Ankesave, për shqyrtimin e ankesave të palëve në procedurën e dhënies në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës;
8. Të ndryshme.

Kryesuesi e hapi mbledhjen e rregullt, mbledhja e gjashtë me radhë e Kuvendit duke i përshëndetë pjesëmarrësit, verifikoj pjesëmarrjen e delegatëve dhe konstatoj se në mbledhje janë prezent 23 asamblist (mungojnë me arsye:Agnesa Vokshi, Lirije Zukaj, Mon Selmonaj dhe Shkelqesa Hadergjonaj).

Kryesuesi- e prezantoi rendin e punës të propozuar me ftesë, në vazhdim ka njoftuar se është rekomandim i KPF-së që të hiqet nga rendi i ditës pika nr.3. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës së Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sporte për bashkëfinancim me CHWB Kosova, në projektin “Muzealizimi i Kullës-Muze të Dëshmorëve” në Gllogjan-shuma 24,500 €, për arsye se është tërhequr bashkëfinancimi, për arsye se është tërhequr bashkëfinancimi i projektit nga kompania në fjalë.

Kestrim Avdimetaj-pyet, se a ka arsyetim pse është tërhequr bashkëfinancimi i projektit.

bashkëpunimi që nuk është nënshkruar për arsye që nuk kemi pasur buxhet, ndërsa tash që e kemi buxhetin kompanisë bashkëfinancuese të projektit i kalon koha e projektit.

Albesa Cacaj- në nenin 6 të Marrëveshjes ceken arsyet pse shkeputet marrëveshja, e jo për arsyet që u ceken nga ju, nëse ata tërhiqen për arsye të tjerë duhet të epin përgjegjësi, mirëpo edhe këtu në marrëveshje ceket se një muaj përpara duhet të njoftohet për tërheqje para tjetër në marrëveshje.

Erdogan Dautaj- thotë se marrëveshja edhe pse është përgaditur prapë nuk është nënshkruar dhe nuk di pse të debatohet këtu për të.

Shkelqim Haxhnikaj-ketu po shkrinë se si komune kompanisë ja kini borgj 8000 euro dhe nëse nuk i kryni obligimet ndaj saj atëherë si komune ju shtinë në liste të zeze.

Milazim Mushkolaj- thotë se nuk di pse po debatoni, rekomandimi është mu hjeke nga rendi i ditës.

Kryesuesi- e qiti në votim rekomandimin e KPF-se për heqje nga rendi i ditës të pikës nr.3, njëzëri pika numër 3. Hiqet nga rendi i ditës.

Kryesuesi-në vazhdim i prezanton pikat që vijnë për shqyrtim me rekomandim të KPF-së.

1.Rivotim për Emrim të rrugës “Adem Zukaj” në fshatin Beleg, dhe 2.Kërkesa e tri shoqatave të luftës për përkrahje financiare, në vlerë 15.000 € .

Rendi i punës pa pikën nr. 3 dhe me dy pikat e rekomanduara nga KPF miratohet njëzëri.

I.Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Ilir Ferizaj- thotë se nuk janë përfshi në tersi diskutimet e tij dhe për këtë do ta dorëzon me shkrim shkresën për përmirësim të procesverbalit të fjala e tij.

Procesverbali miratohet njëzëri me plotësimin të fjala e Ilir Ferizaj, që do të bëhet në procesverbalin e mbledhjes së kaluar sipas shkresës së Ilir Ferizaj.

II. Shqyrtimi i Qarkores së parë buxhetore.

Kryesuesi- e ka prezentu piken pastaj për sqarime fjalën ia kalon drejtorit të buxhetit, Agron Demukaj i cili për të pranishmit ka sqaruar se sot si kuvend ju njoftoheni me Qarkoren e parë buxhetore dhe do të caktoni grupet punuese për organizimin dhe mbajtjen e debateve publike, shqetësim imi edhe për këtë Qarkore mbetet minusi në grandin për Arsim dhe shuma e lartë e përcaktuar për inkasim të hyrave vetanake.

Drejtori ka thënë se është planifikuar që të mbahen katër debate publike: 1. Takim me Kryesuesit e këshillave të fshatrave për Qarkoren Buxhetore, 2. Debat për Grandin e Arsimit, 3.Debat i veçantë për Grandin e Shëndetësisë, dhe 4 Debat i përgjithshëm me qytetar për Qarkoren e parë buxhetore.

Ismet Çekaj- thotë se kryesuesve të fshatrave ju ka kalu mandati dhe janë pa mandat.

Albesa Cacaj- pyet pse po paraqitet për çdo vit problem me buxhetin për arsim.

Bekim Vishaj, drejtor i Arsimit- thotë se situata në arsim është e keqe sa i përket buxhetit sepse fajti është të rrëmja e numrit të nxënësve ndërsa buxheti caktohet sipas formulës për koke të nxënësit, ai sqaron se asnjë puntor i arsimit nuk është mbi normë dhe ky është problem i përgjithshëm në arsim në Kosovë.

Erdogan Dautaj-pyet sa kemi buxhet për investime kapitale.

Drejtori i buxhetit- sqaron se sipas parashikimeve për kapitale i kemi plus minus 2 milion €, por kanësemi mu demtu edhe gjysmë milioni për arsim sepse ligji për kontarte kolektive nuk po mbulohet nga qeveria me buxhet kurse po ekzekutohet përmes gjykatës me kërkesë individuale të çdo punëtori të arsimit.

Shkelqim Hazhnikaj- pyet sa mund të inkasoni të hyra në vitin që vjen.

Drejtori buxhetit- përgjigjet se mund të inkasohen deri 700.000 €.

Milazim Mushkolaj-pyet sa implementohet buxheti i komunës nëse zbatohet kontrata kolektive, sa punëtorë e gëzojnë atë të drejtë brenda viti dhe a i kanë drejtoritë përgjegjëse këto shënime.

Agron Demukaj, drejtor i buxhetit- përgjigjet, po,i kemi të gjitha shënimet dhe mund të jua sjellim me Qarkoren e dytë buxhetore ose drejtorja e arsimit jua bjen mbledhjen tjetër listën e puntorve përfitues. Poashtu në e kemi vendimin e kuvendit për pagim të shujtave të puntorve por nuk kemi buxhet të dedikuar për rate qeshtje dhe ju si asamble duhet me vendosë ku po i hjekim një projekt për me i realizu shujtat.

Florim Mataj-thot se ne si asamble i kemi kordinu pikat me Akzekutivin per çdo vendim qe eshte marre këtu dhe eshte dashtë me ardhe dikush këtu nga ekzekutivi me ju tregu se ku duhet te hjekem mjetet, ne cilin projekt per shujta.

Valdet Nuraj-pyet se a eshte ekzekutu nje vendim per KF "Deçani", nëse jo, pse,

Drejtori buxhetit- pergjigjet se jemi tuj e prite alokimin e mjeteve buxhetore qe do te behet me 5 a 6 qershor, plus i kemi edhe 20.000 € per bursa te studenteve dhe ju duhet ta formoni komisionin.

Valdet Nuraj- pyet, a eshte dashtë Drejtoria e Kutures me i njoftu Klubin e futbollit kure alokohen mjetet, poashtu ai ka bere vërejtje pse nuk eshte vendose ne salle Llogoja e re e komunës e cila eshte ndërruar dhe ka kërkuar qe mbledhjen e radhës Llogoja te vendoset ne salle .

Albesa Cacaj- ka thene qe sa kohe ne po kërkojmë mi bo ni plan Drejtoria e Kultures per shpërndarjen e buxhetit per te gjitha klubet brenda nje viti.

Erdogan Dautaj-kerkon mos me dale jashtë teme, mirëpo te gjitha qeshtjet te ngritën ne fund te mbledhjes ne te ndryshme sepse po i humbe kuptimi debatit rreth temës se caktuar kur po dalim krejtësisht jashtë teme, pastaj ka pyet se a do te aplikohet shujta per femij kete vit.

Bekim Vishaj, drejtor i Arsimit- pergjigjet, po, shujta per femij do te apikohet prej muajit shtator kete vit.

Milazim Mushkolaj-thot se per sport nuk eshte faji te drejtoria e kulturës por te gjitha sportet subvencionohen nga Qendra sepse Kryetari dhe Drejtoria e Kultures nuk kane shum buxhet dhe nuk mund ti mbulojnë te gjitha shpenzimet e sportit ne te gjitha disiplinat.

Kryesuesi- ka kërkuar qe te formohen grupe punuese per organizim te debateve publike per Qarkoren e pare buxhetore.

Ne vazhdim formohen grupet punese.

-Grupi punues për organizimin e debatit publik për Grandin e Shëndetësisë, formohet me këtë përbërje:

1.Agnesa Vokshi (AAK), 2.Shkelqesa Hadergjonaj (PDK), 3.Rejhana Tolaj (LDK), 4.Illir Ferizaj (PSD), 5.Agron Demukaj, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa.

Debati publik mbahet me 07 Qershorë ora 10:00.

-Grupi punues për organizimin e debatit publik për Grandin e Arsimit, formohet me këtë përbërje:

1.Milazim Mushkolaj (AAK), 2.Shkelqim Haxhnikaj(LDK), 3.Kestrim Avdimetaj(PDK), 4.Natyra Kuçi (PSD), 5. Agron Demukaj, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa

Debati publik mbahet me 07 Qershorë ora 11:00.

-Grupi punues për organizimin e debatit publik me Kryesuestë e Këshillave të fshatrave, për Qarkoren buxhetore 2022/01, është Komiteti për Politikë dhe Financa (KPF), me këtë përbërje:

1.Haki Shehaj,kryesues i KPF-së me antarët e KPF-së, 2.Valdet Nuraj, 3.Albana Avdiu, 4.Kushtrim Loshaj, 5.Albesa Cacaj, 6.Mon Selmonaj dhe 7. Natyra Kuçi si dhe nga Ekzekutivi, Agron Demukaj, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa

Debati publik mbahet me 07 Qershorë ora 13:00.

Debati publik me qytetar për Qarkoren buxhetore 2022/01 , i organizuar nga Asambleja Komunale do të mbahet me dt.17 Qershor në ora 11:00.

III. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës së Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sporte për bashkëfinancim me CHWB Kosova, në projektin "Muzealizimi i Kullës-Muze të Dëshmorëve" në Gllogjan-shuma 24,500 €.

Kjo pikë eshte hjeke nga rendi i ditës.

IV. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës së Drejtorisë për BPZHR për ndarjen e mjeteve financiare për hapjen dhe mirëmbajtjen e kanaleve të ujitjes në bashkë-financim me K.R.U."Drini i Bardhë".

BPZHR, Rifat Stojkaj, i cili ka sqaruar se marrëveshja e arritur mes Kryetarit të Komunes dhe Ndermarrjes KRU "Drini i Bardhë" obligon komunën që të ndaj buxhet në vlerë 16.500 euro kurse Ndermarrja KRU Drini i Bardhë obligohet që të hape të gjitha kanalet e ujitjes në Komunën e Deçanit gjatë vitit 2021 sipas kërkesës së komunës, sipas kësaj marrëveshje përfitojnë fermerët të cilëve u paguhet taksa vjetore për ujitje të tokës.

Albana Avdiu- thot se edhe në KPF e kam ngritë këto tema, të cilën po e përsëris edhe këtu, Ndermarrja Higjiena mundet të kryjë punët të cilat do të kryen Drini i Bardhë, unë jam, ka thënë ajo, për përkrahje të çdo kërkesë ku përkrahet bujqësia dhe fermerët tona, por mos jini ngute pak në lidhjen e marrëveshjes me Drinin e bardhë kur këto punë kishte duhet të kryjë ndërmarrja Higjiena dhe kërkonte këto mjete buxhetore kishin duhet të mbete në Deçan, nëse Ndermarrja Higjiena e kemi krye këto punë disa herë deri tash ku kemi hape disa kanalet të ujitjes në disa fshatra, mirëpo meqenëse këto herë keni hyrë në procedurë me këto ndërmarrje, kërkoj që viteve tjera të shqyrtojmë mundësinë që këto punë të kryjë ndërmarrja Higjiena sepse të fundit ata kurrë nuk kanë bërë për Deçanin.

Rifat Stojkaj- thot se në të ndajmë 16.500 euro dhe fermerëve ju paguhet taksë e ujit për 330 hektar nga 50 euro hektari.

Albana Avdiu- thot se ata janë obligativ me të hape kanalet, në edhe vitin e kaluar kemi ndaluar mjete për hapje të kanaleve në bashkëpunim me këto ndërmarrje dhe nuk dijmë sa janë krye ato punë.

Rifat Stojkaj- thot se janë 330 hektar për këto vit që ju hiqet taksa, ndërsa për vitin e kaluar janë bërë raportin sa kanalet janë hapur.

Florim Mataj-sipas propozimit nëse si komune po paguajmë komplet taksën, kurse fermerët e fshatit të cilin janë kërkonte të pa kështu me punën e kësaj ndërmarrje sepse si fshat kemi përfituar vetëm me hapje të një kanali të vogël ku ka punuar eskavatori vetëm 2 orë.

Besnik Hula- sugjeroj që kërkesa në këto formë me qenë e fundit, sepse nuk ujitën kërkonte tokat, nuk kemi pasur ujë vitin e kaluar hiq, sugjeroj që këto përgaditje vitin tjetër të kryhen më herët nëse dëshirojmë që të përfitojnë fermerët, dhe shtroni pyetjen sa fshatra përfshihen në këto marrëveshje.

Drejtori i BPZHR- thot se kuptoj se menagjimi nuk ka qenë edhe aq i mirë por nëse kemi menduar me ju ndihmu fermerëve aq sa kemi mundësi.

Florim Mataj- thot se më mirë na si komune me të dhanë këto punë Ndermarrjes Higjiena sepse të kryen punët menjëherë.

Albesa Cacaj-thot sipas marrëveshjes ju duhet të dërgoni listën e kanaleve që do të hapen, prandaj shtroni pyetjen se a e keni bërë këtë listë.

Drejtori- jo, nuk e kemi bërë listën por ka më mirë të takohemi me Komunitetin, Komunitetin dhe kryetarët të fshatrave dhe aty kanë më mirë kanalet.

Albesa Cacaj- pyet, pse vjetër janë 11.000 € kurse sivejt 16500 euro, a janë kanalet e njëjta apo të ndryshme.

Drejtori- përgjigjet, jo, nuk janë të njëjta sepse disa janë krye vjetër dhe nuk kanë nevojë këto vit për intervenim.

Albesa Cacaj- pyet, nëse kanalet hapen por nuk ka ujë, ku do të adresohet ankesa.

Drejtori- përgjigjet se nuk kemi të kështu me punën e kompanisë por për hire të fermerëve duhet me punë.

Albesa Cacaj- në momentin kur miratohet kjo kërkesë sot, ju pastaj duhet me kërku përgjegjësi nga kompania.

Drejtori- përgjigjet, kam më mirë me raport në fund të sezonit, ndërsa vitin e kaluar të kemi krye kërkonte punët.

Kryesuesi- pyet, sa është kompetente si ndërmarrje në nivel komunal me të krye këto punë Drini i Bardhë.

Rifat- për kanalet të ujitjes na mund të bëjmë kontratë edhe me dike tjetër, por Drini i Bardhë si kompani menagjon me ujë të ujitjes së tokës dhe duhet me të hape edhe kanalet.

Florim Mataj- pyet, sa kilometra kanalet të kemi në total si komune.

ndërsa dikujt i ipet fjala disa here gjate shqyrtimit te nje pike dhe ate rend e pa rend.

Kushtrim Loshaj-thot se jam per kete marrëveshje per përkrahje te fermëve por nëse ata si kompani e paskan obligim ligjore na si kuvend na eshte dashtë vetëm me i nda mjetet buxhetore per lirim te fermerëve nga pagesa e taksës pe ujitje te tokave bujqesore.

Ismet Çekaj pyet a ka mundësi qe nje kanal te hapet dhe te kryhet mire nje vit dhe mos te ka nevoje mu marre me te vitin tjetër.

Drejtori i BPZHR- thot se kjo marrëveshje nuk eshte per betonim te kanaleve, vetëm per hapje dhe pastrim.

Kryesuesi e qiti ne votim kërkesën e Drejtorisë për BPZHR për ndarjen e mjeteve financiare për hapjen dhe mirëmbajtjen e kanaleve të ujitjes në bashkë-financim me K.R.U."Drini i Bardhë", në shumën prej 16,500.00 €, Asamblistet e miratuan me shumic votash, rezultati votimit ishte 15 per, 1 kundër, 2 apstenim, mjetet financiare do te merren nga Zyra e Kryetarit ose Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural .

V. Shqyrtimi i propozimit të Kryetarit për miratimin e Vendimit paraprak për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës- parcela nr.1294-1 Zk Deçan dhe formimi i komisionit vlerësues.

Drejtori buxhetit sqaron se banoret i kane prurë nënshkrimet per ndërtim te nje objekti te ri ne vendin e asaj ekzistuese, do te ndërtohet sipas planit rregullues.

Albesa Cacaj- ka kërkuar sqarime shtese .

Mehmet Osaj- ka thene se jam per dhënie por jam edhe per raportim, ne kete rast ai perserite kërkesën per raportim te 5 Lloteve.

Ismet Çekaj- pyet pse nuk eshte këtu drejtori Urbanizimit apo kadastrit me na dhanë sqarime ma te hollsishme, prandaj per mungese te sqarimeve une jam kundër ka thene ai.

Florim Mataj- thot se une jam per kete propozim, meqenëse do te vazhdon me procedura dhe ndërtesa ekzistuese eshte shum e keqe, edhe Milazim Mushkolaj eshte i nje mendimi me Florimin.

Miratohet vendimi paraprak me shumic votash, 15 per, 4 kunder, 1 apstenim.

Formimi Komisionit Vlerësues: Besnik Hulaj (AAK), Mon Selmonaj (PDK) Adelina Ukaj(OJQ), Agron Demukaj dhe Izet Zenuni.(Ekzekutiv).

VI. Formimi i dy(2) komisioneve Vlerësuese për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës.

1. Formohet Komisioni Vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës, në këtë përbërje:1.Rexhë Sutaj,antar, (nga asambleja -AAK), 2.Illir Ferizaj,antar,(nga asambleja-PSD), 3. Mujë Kadriaj (nga Ekzekutivi), 4.Halil Tolaj (nga Ekzekutivi),5.Zelfije Qorraj, antare,(OJQ).

Komisioni ka mandat për zhvillimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të Pronës komunale te Njësia Kadastrale Rastavicë , parcela nr.00736-0.

Formohet Komisioni Vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës, në këtë përbërje:1.Besjana Ukëhaxhaj,antare, (nga asambleja -AAK), 2.Rejhana Tolaj,antare,(nga asambleja-LDK), 3. Rasim Alaj (nga Ekzekutivi), 4.Ismet Kukleci (nga Ekzekutivi),5.Curr Mazrrekaj, antar,(OJQ).

Komisioni ka mandat për zhvillimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të Pronës komunale, Parcela nr.01098-0, Zona Kadastrale Drenoc.

VII.Formimi i Komisionit të Ankesave, për shqyrtimin e ankesave të palëve në procedurën e dhënies në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës;

Formohet Komisioni ne kete përbërje:1.Milazim Mushkolaj (nga asambleja -AAK), 2.Shkelqim Haxhnikaj (nga asambleja-LDK), 3. Enver Cacaj (nga Ekzekutivi), 4.Besart Cacaj (nga Ekzekutivi),5.Nexhat Musaj (OJQ). Kjo përbërje miratohet njëzëri.

Me rekomandim të KPF-së janë shqyrtuar:

VIII.Kërkesa për Rivotim të rrugës "Adem Zukaj", emrimi i kësaj rruge eshte bere me vendim te Kuvendit te muajit Mars, mirëpo me rekomandim te MEA kjo rruge eshte dashtë te shqyrtohet dhe te votohet edhe nje here per harmonizim te vendimit me ligjin. Sipas vendimit te kaluar rruga eshte

emroht rruga “Adem Zukaj” ne fshatin Beleg, ky vendim merret njëzëri.

IX.Kërkesa e tri Shoqatave te Luftes per përkrahje financiare.

Kryesuesi- njoftoj se eshte rekomandim i KPF-se qe te ndahen 15.000 € per tri shoqatat e luftës, prej tyre 10.000 € per OVL e UÇK-së, 3500 € per Shoqaten e Invalidëve të Luftës dhe 1500 € per Shoqaten e familjeve te Deshmorve.

Mehmet osaj- thot se janë shumë pak këto mjete per funksionimin e tri shoqatave gjate vitit 2021.

Drejtori i buxhetit ka dhene sqarime per kërkesat e tri shoqatave dhe mundësitë financiare per ti përkrahur.

Miratothen njëzëri 15,000.00 € per përkrahje financiare per tri shoqatat e luftës, prej tyre 10.000 € per OVL e UÇK-së, 3500 € per Shoqaten e Invalidëve të Luftës dhe 1500 € per Shoqaten e familjeve te Deshmorve.

X.Kerkesa e Kryesuesit te Komitetit te Komuniteteve per përkrahje financiare per ta ndihmuar ne ndërtim te shtëpisë se familjes Qekiqaj.

Kryesuesi- ka njoftuar se kërkesa eshte shqyrtuar ne KPF dhe eshte rekomanduar per shqyrtim ne Kuvend.

Drejtori buxhetit- njofton se si Ekzekutiv e kemi marre parasyshe kërkesën e familjes Qekiqaj, ju njoftoj se si komune jemi ne negociata per nënshkrim te marrëveshjes me Jetimat e Ballkanit ku do te përfshihen edhe familje tjera me nevoj per strehim perveq familjes Qekiqaj nga komuniteti RAE dhe nëse e finalizojmë marrëveshjen me Jetimat e Ballkanit mbledhjen tjetër dalim me propozim konkret.

Kestrim Avdimetaj- thot se kërkesa eshte e pa specifikuar dhe nuk dijmë sakte sa po kërkohet përkrahje nga komuna, ai njofton se shqetësim i Komitetit te Komuniteteve ka qene se vazhdimisht i drejtohem i ekzekutivit me kërkesa por nuk po marrim përgjigje.

Kryesuesi- ka thene se personalisht jam marre me kete kerkese dhe do te merrem prap e do te jau japim përgjigjen.

Kerkesa njëzëri shtyhet, dhe pasi te nënshkruhet marrëveshja me Jetimat e Ballkanit do te merren me kete kerkese.

4.Ankesa e Shkodran Imeraj per ndryshim te emrit te rrugës ne fshatin Isnig, rruga eshte qujte “Cen Imeri” dhe tani eshte emru “Roshkodoli”

Shkelqim Haxhnikaj- ka thene se si komision per emrim te rrugëve i kemi pase te gjitha nënshkrimet e qytetarve per ndryshim te emrit, mirëpo ka shtuar ai se aty ka probleme dhe kish qene mire me i mbledhë fshatin dhe me u marre vesh mes veti atje.

Mustafë Selmanaj- antar i komisionit, sqaron se si komision kur kemi vendose i ka plotesu kriteret emri “Roshkodoli” sepse ky emër ka qene ne listën rezerve te emrave te rrugëve, une personalisht jam per mi shty kete ankese.

Shkelqim Haxhnikaj- thot se ne kemi vendose sipas rregullores.

Kryesuesi- e qiti ne votim propozimin e Mustafes qe te shtyhet kjo kerkese, antaret e asamblesë e miratuan, shtyhet , do te shqyrtohet pasi pala te bjen nënshkrimet e qytetarve pas konsultimit ne fshat me strukturat udhëheqëse te fshatit.

Erdogan Dautaj- ka ngrite qeshtjen e riparimit te rrugës Ledinaj e cila eshte ne gjendje te keqe.

Albana Avdiu- paraqet kërkesën e fshtatit Gramaqel, per gjetjen e nje zgjidhje per qent endacak sepse fëmijët janë shumë te rrezikuar, si dhe kërkon qe sot te formohet komisioni per ndarjen e bursave te studenteve.

U vendos qe komisioni per ndarjen e bursave te formohet muajin tjetër.

Ismet Çekaj- ka ngrite qeshtjen e vendosjes se nje pllake me emrat e te zhdukurve duke kerkuar qe te korrigjohet ajo pllake sepse nuk ka dale me emra te sakte.

Vadet Nuraj- ka thene se përgjegjës per Zyren e te zhdukurve eshte Demë Ramosaj, i cili nuk eshte konsultu kur e ka nxjerre listën, por ajo liste duhet te korrigjohet sepse ka lëshime, poashtu ai ka ngrite edhe nje kerkese qe e ka bere edhe disa here me pare per vendosjen e sinjalizuesve ne rruge te

sinjalizuas te vendosur ne rruge qe tregon "Kujdes shkolla".

Drejtori Arsimit, Bekim Vishaj- ka njoftuar se per shkollat tjera eshte krye ndersa per Strellc ne rrugen kryesore nuk di kompetenc e kujt eshte vendosja e shenjave te sinjalistikes.

Si përfundim ka dale Kerkese e Kuvendit per Ekzekutivin qe organet kompetente te ekzekutivit te merren me qeshtjen e sinjalistikes ne fshatin Strellc .\Valdet Nuraj- ka sqaru qeshtjen e procedurave me Ministrine si kompetence e tyre.


Florim Mataj- ka sqaruar se vendosja e shenjave te sinjalistikes ne ate rruge eshte e Ministrise ,mirëpo ne duhet me bo presion.

Albesa Cacaj- ka paraqite një kërkesë të qytetarve te Deçanit, qe te ndërtohet rrethoja te brana te shtrati i lumit ne Deçan sepse eshte vend i rrezikshëm, sidomos per fëmijët.

Kryesuesi- i falënderoj pjesëmarrësit për kontributin e dhënë pastaj e shpalli mbledhjen për të mbyllur.

Procesmbajtëse:

Dyke Ljolluni



Verifikon procesverbalin:



Kryesuesi i Kuvendit:
Haki Shehaj

